
THE CONTRIBUTION OF USA IN BALKAN EUROPEANIZATION

Zeqirja Rexhepi

University of Tetovo, Tetovo, Macedonia, zeqirja.rexhepi@unite.edu.mk

Abstract: After the communist system fall, the countries in the Balkan region have faced a historical period known as “*transition*”, a period in which the parliamentary democracy and market economy were established. Having a sustainable historic past, Balkan countries overcome the transition phase with numerous contradictions, by protecting the borders of nation-states. Whereas, in Federative Yugoslavia, a state without a historical past, new political realities were created; a process which went through many wars and as a result, new national countries were established in the Balkans. Actually, in this corner of Europe, seventy years after Yugoslavia’s constitution as a state, the process of “dismantling” the creation of Versailles begins. In the Treaty of Versailles (1919), the United States had attempted to give its contribution to build the 20th century Europe through the process of “self-determination”, but at that time American proposals were not taken into account. However, issues of the early 20th century were again put to the table in the late 20th century, The role of America at this period was quite different. In the late twentieth century America was engaged in various world regions as a “guardian” observing the global processes of contemporary civilization. In this context, noticing the “Europeans” inability, USA has got involved to a great extent in the development processes of the Balkans, contributing to the establishment of peace, political stability and the parliamentary democracy system, which in fact constitute the foundations for the “Europeanization” of the peoples and countries of the Balkans.

Keywords: system, democracy, transition, Europeanization, Balkan.

KONTRIBUTI I SHBA-SË NË EVROPIANIZIMIN E BALLKANIT

Zeqirja Rexhepi

Universiteti i Tetovës, zeqirja.rexhepi@unite.edu.mk

Abstrakt: Pas rënies së sistemit komunist vendet e rajonit të Ballkanit janë përballur me një periudhë historike që njihet si “*tranzicion*”, periudhë kjo në të cilën vendoset demokracia parlamentare dhe ekonomia e tregut. Vendet ballkanike me të kaluar historike të qëndrueshme fazën e tranzicionit e kaluan me shumë kundërthënie, duke ruajtur kufijtë të shteteve-kombe. Ndërkaq, në Jugosllavinë Federative, një shtet pa të kaluar historike, u krijuan realitete të reja politike, proces ky që kaloi nëpër shumë luftëra me ç’rast krijohen shtete të reja kombëtare në Ballkan. Në të vërtetë, në këtë cep të Evropës, shtatëdhjetë vjet pas krijimit të Jugosllavisë si shtet, fillon procesi i “demontimit” të krijesës së Versajës. SHBA-të, ishin përpjekur në Traktatin e Versajës (1919) të japin kontributin e saj, përmes procesit të “*vetëvendosjes*” të ndërtohet Evropës e shekullit XX, por atëbotë propozimet amerikane nuk ishin marrë parasysh. Afërsisht në fundshekullin e XX-të, sërish ishin vënë në tryezë çështjet e fillimshkullit. Roli i Amerikës në këtë kohë ishte krejt i ndryshëm. Në fundshekullin e XX-të Amerika ishte e angazhuar në rajone të ndryshme të botës, si një “kujdestar” që përkujdesej për proceset globale të qytetërimit bashkëkohor. Në këtë kontekst, SHBA duke vërejtur paaftësinë e “*Evropianëve*” në masë të madhe është inkuadruar në zhvillimin e proceseve në Ballkan, duke dhënë ndihmesën e vet në vendosjen e paqes, stabilitetit politikë dhe sistemit të demokracisë parlamentare, që në të vërtetë përbëjnë themelin kryesore për “evropianizimin e popujve dhe vendeve të Ballkanit.

Fjalë kyçe: Sistemi, demokracia, tranzicioni, evropianizimi, Ballkani.

HYRJE

Evropa njihet si toka në të cilën janë zhvilluar të gjitha proceset historike, që lanë gjurmët e tyre në zhvillimin e qytetërimit evropian, për të arritur deri në periudhën bashkëkohore, kur vlerat e sistemit të demokracisë parlamentare kanë arritur një fazë tejet të zhvilluar. Mirëpo, edhe pse Evropës nuk mund t’i mohohen atributet historike të parlamentarizmit, SHBA, një shtet me histori shumë më të shkurtër se sa Evropa, gjatë shekullit XX luajtën rolin kryesor në afirmimin dhe kultivimin e vlerave të sistemit të demokracisë parlamentare. Pas rënies historike të sistemeve totalitare, siç ishte fashizmi dhe komunizmi, Amerika e zëvendëson Evropën, në rolin e “lokomotivës” së të gjitha proceseve shoqërore në Botë, por edhe në Evropë. Në të vërtetë, Amerika e merr rolin e kujdestarit permanent të zgjerimit të hapësirës së demokracisë parlamentare dhe ekonomisë së tregut, duke e mbështetur ngritjen e institucioneve të përgjegjshme për kultivimin e vlerave të sistemit të demokracisë parlamentare.

Në historinë e qytetërimit evropian krahas zhvillimeve shoqërore politike janë përpunuar edhe teori të ndryshme mbi sistemet politike dhe mbi shtetin, mbi bazë të të cilave është krijuar *identiteti politik* dhe *identiteti kombëtar evropian*. Evropa është vendi ku lindi koncepti mbi kombin dhe është zhvilluar *shteti kombëtar*, që është *shpikja më e suksesshme e historisë evropiane*.

Shteti – kombëtar evropian e merr formën e vet në kohën e Revolucionit Francez. Edhe pse proceset shoqërore politike në Francë, gjatë kohës së Revolucionit “rrëshqitën” drejt diktaturës, megjithatë idetë revolucionare të tij patën jehonë në tërë Evropën. Pikërisht, gjatë shekullit XIX mbi themele të idealeve kombëtare, në shtetet shumëkombëshe (perandori) janë themeluar *Lëvizjet Kombëtare* për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lëvizjet kombëtare gjatë shekullit XIX dhe XX, e shpërbënë “Evropën e Perandorive” dhe e krijuan “Evropën e Kombeve”, duke krijuar kështu një hartë të re të Evropës.

Jehona e ideve të Revolucionit Francez dhe e lëvizjeve tjera kombëtare evropiane, ndihet edhe tek popujt e Ballkanit, që ishte nën administrimin e Perandorisë Osmane. Në këtë pjesë të Evropës, lëvizjet kombëtare fillimisht patën karakter çlirimtar, por pas krijimit të formacioneve të para shtetërore dhe njohjes së tyre nga Fuqitë e Mëdha, kombet e vogla ballkanike bënë plane për të mbizotëruar mbi popujt tjerë, duke u mbështetur tek ndonjëra nga fuqitë evropiane. Edhe pse Rendi ndërkombëtar i Vjenës e kishte vendosur të ashtuquajturin parim “staus-quo”, por megjithatë fuqive pretendente (Rusia dhe Austro-Hungaria), sa herë që u jepej rasti i shtrinin politikat e tyre ekspansioniste. Shtetet-kombe ballkanike të sapoformuara, të mbështetura në prapaskenë nga “aleati” i madh (Rusia), në emër të “çlirimit” të vëllezërve me prejardhje të përbashkët, në fakt marrin rolin e “dorës së zgjatur” të politikave ruse në Ballkan. Përpjekjet e këtylla politike të Rusisë në Ballkan do të lënë pasojë tepër të rënda në marrëdhëniet e kombeve ballkanike, pasojë që duhet t’i vuajmë edhe brezat e sotëm.

Gjatë shekullit XIX, kur Evropa merr formën përfundimtare të copëzimit të saj – në *shtete-kombëtare*, kombet e mëdha: anglezët, francezët, gjermanët, italianët... i drejtonin marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë periudhë historike, SHBA ishte në fazën e konsolidimit si fuqi e madhe, ndërkaq politika e saj e jashtme ishte e mbyllur në hemisferën perëndimore (doktrina Monro). SHBA, del në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës së Parë Botërore, pra në fillim të shekullit XX, roli i politikës së jashtme të saj vjen duke u rritur gjithnjë e më tepër.

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE EVROPIANE DHE BALLKANI

Marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropë, tradicionalisht ishin drejtuar sipas principit të *ekuilibrit të forcës*, mirëpo me daljen në skenë të Gjermanisë dhe Italisë, principi i përmendur vihet përballë konceptit Realpolitik. Vlen të theksohet se, të dy parimet për të cilat angazhoheshin shtetet-kombe evropiane (Fuqitë e Mëdha), e çonin shoqërinë evropiane drejt rirreshtimeve të reja dhe konfrontimit. Parimet e sipërpërmendura e çuan shoqërinë evropiane në krijimin e dy aleancave, të cilat u përplasën në Luftën e Parë Botërore. SHBA-të i përbuznin të dy principet e evropianëve dhe ofronin parime mbi të cilat duhej ndërtuar Rendi Botëror, si: demokracia, sigurimi kolektiv dhe vetëvendosja (Kissinger, 1999).

Gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, SHBA përpiqet t’u imponojë Fuqive Evropiane parime morale të politikës së saj të jashtme: *sigurimin kolektiv* dhe *vetëvendosjen e popujve*. Kjo përpjekje fillon me angazhimin e Presidentit demokrat Udrou Uillson, i cili ishte përpjekur të ndërmjetësojë midis palëve për një zgjidhje paqësore të luftës. Fillimisht ai arrin një marrëveshje me britanikët, më 1916, e cila njihet si *Memorandumi i datës 22 shkurt 1916* (Zenelaj, 2013). Me këtë rast, aleatët e Antantës janë siguruar se do të marrin ndihmën amerikane nëse Gjermania do të refuzojë paqen e propozuar. Perandori i Gjermanisë e refuzon projektin e ofruar dhe më 1917, SHBA hynë në luftë për t’i dhënë fund asaj dhe për vendosjen e zgjidhjeve afatgjate. Mirëpo, gjatë marrëveshjes së paqes në Paris (1919), diplomacia tradicionale e kombeve evropiane bëri të kundërtën e asaj që mendonte diplomacia amerikane (Uillsoni). Epilogu i vendimeve të evropianëve ishte rikthimi i kundërtënieve, të cilat sollën Luftën e Dytë Botërore. Ndërkohë që politika e jashtme amerikane sërish mbyllet në hemisferën perëndimore - *politika izolacioniste*.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Evropa ndahet midis aleatëve fitues, mbi bazë ideologjike, në LINDJE dhe PERËNDIM. Në Perëndim bënin pjesë vendet, në të cilat do të ringrihet ekonomia e tregut dhe institucionet e demokracisë parlamentare, ndërsa në Lindje do të bënin pjesë vendet, në të cilat do të vendoset i ashtuquajturi sistem i demokracisë popullore dhe ekonomia shtetërore. Me ndryshimet që ndodhën në Marrëveshjen e Jaltës (1944) rritet numri i vendeve evropiane që hynë në sferën e të ashtuquajturave “*demokracive popullore*”. Disa nga këto vende dhe popuj evropianë “integrohen” në kuadër të *Bashkimit Sovjetik*, ndërsa vendet tjera, ku hynin edhe vendet e rajonit të Ballkanit, “integrohen” në sistemin e *demokracive popullore* (komunist) me sovranitet të kufizuar. Në kohën e *Luftës së Ftohtë*, SHBA luajtën rolin kryesor në kultivimin dhe mbrojtjen e vlerave të sistemit të demokracisë parlamentare dhe ekonominë e tregut.

Betonizimi i sistemit komunist u çka më 1985, atëherë kur Mihail Gorbaçovi filloi programin për ristrukturim ekonomike (perestrojka), program ky që ishte i shoqëruar edhe me një përfaqje të re sociale dhe intelektuale (glasnost) që vuri në diskutim bazën mbi të cilën ishte ndërtuar i gjithë sistemi sovjetik (Albright, 2004). Përderisa administrata e Presidentit Bush i Vjetër, në përfundim të Luftës së Ftohtë (1989/90), e shpalli RENDIN E RI BOTËROR, që nënkuptonte partneritetin e ri midis kombeve: *rritjen e sistemit të demokracisë parlamentare, rritjen e begatisë, vendosjen e paqes dhe shkurtimin e armëve* (Kissinger, 1999). Administrata e Presidentit tjetër të SHBA-së, Bill Clinton, sipas dëshmisë së Sekretarit të Shtetit të SHBA-së synimet e SHBA-së në Evropë ishin: Zgjerimi i NATO-s dhe nxitja e integritetit të Rusisë në Perëndim dhe ulja e rrezikut të ndarjes së Botës. Krahas këtyre synimeve gjenerale amerikane, për një të ardhme më të mirë, politika e jashtme amerikane ishte e interesuar qetësisht në mbylljen e konflikteve të armatosura dhe vendosjen e paqes në rajonin e trazuar të Ballkanit. Në përfundim të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, SHBA angazhoheshin për jetësimin e tërësishtëm të Marrëveshjes së Dejtonit (Albright, 2004).

SHBA DHE ZHVILLIMI I PROCESVEVE NË JUGOSLLAVI

Plani i Presidentit Bill Clinton, ishte krahas zgjidhjes së konflikteve në Ballkan, në Evropën Lindore të krijohej një “sferë interesash të përbashkëta”, ku çdo komb do të mund të jetonte i lirë dhe i sigurt. Për këtë arsye, fillon procesi i vendosjes së lidhjeve midis NATO-s dhe vendeve të Evropës Lindore, nëpërmjet *Partneritetit për Paqe*. Mirëpo, ajo që zhvillohej në Jugosllavi nuk mundëonte realizimin e objektivave amerikane.

Në Ballkan, ose më saktësisht në vorbullën e konfliktit, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë, politika e jashtme amerikane përballet me agresorë specifikë, të cilët e sfidonin, jo vetëm politikën e jashtme amerikane, por edhe qytetërimin bashkëkohor dhe vlerat elementare të demokracisë.

Nga fundi i rënies së komunizmit, në skenën politike serbe ishte ngjitur një klasë politike totalitare, e cila nuk dallonte aspak nga ato të fashizmit. Drejtuesi kryesor i kësaj klase politike, Slobodan Millosheviqi, nuk dallonte fare nga drejtuesit e fashizmit. E frymëzuar nga projekti i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, klasa politike nacionaliste serbe, fillimisht e vendosi nën kontrollin e saj Armatën Jugosllave, për të realizuar me forcën e armëve të realizojë projektin e “Serbisë së Madhe”. Akoma pa shpërthyer pluralizmi politik, Kosovës, e cila kishte gëzuar statusin e njësisë federale në Jugosllavi, iu imponua zgjidhje e dhunshme kushtetuese, me të cilën Serbia i hiqte autonominë politike territoriale. Përderisa zhvillohej konflikti i armatosur në Slloveni dhe Kroaci, Kosovës i kërcënohej rreziku për t’u shndërruar në kasaphanë të vërtetë. Për këtë arsye, diplomatët amerikanë të administratës së Bushit të Vjetër, në Ditën e Krishtlindjeve të vitit 1992, e njoftuan Millosheviqin se SHBA-ja *do të kundërpërgjigjej ushtarakisht nëse serbët do të fillonin ndonjë konflikt të armatosur në Kosovë* (Albright, 2004).

Jugosllavia si një shtet shumëkombësh pa attribute historike, në kapërcim nga sistemi komunist në sistemin parlamentar nuk arrin të mbijetojë dhe aq më tepër bëhet shkak lufte me përmasa të gjera. Në këtë shtet, që në fakt ishte një *eksperiment i diplomacisë evropiane*, kombet qenë të mbërthyer nga pakënaqësitë historike. Duke kërkuar identitetin e tyre, ato zhyten në konflikte dhe luftëra, skenat e së cilës kanë mundur të shihen gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nxitësi kryesor i krizës jugosllave, padyshim ishte udhëheqësi serb, Millosheviqi. Në periudhën historike kur qytetërimi evropian duhej të lëvizte drejt progresit, ekonomisë së tregut dhe vlerave të demokracisë parlamentare, ai synonte të kundërtën, krijimin e “Serbisë së Madhe”. Ai, në të vërtetë synonte të shfrytëzojë parimin ndërkombëtar të *sovrانيتit të shtetit*, dhe sipas modelit makiavelist të Rishelje-së, ku *arritja e qëllimit justifikon mjetet e përdorura*. Atë që nuk e parashikoi udhëheqësi serb ishin parimet e reja, përmes të cilave SHBA përpjekshin t’u japin formë marrëdhënieve ndërkombëtare në hyrje të shekullit XXI.

Megjithatë, modeli i përmendur Risheljan, sipas Kissingerit, ishte gjithnjë i përçmuar nga amerikanët. SHBA-ja, e cila e kishte marrë rolin e Udhëheqjes së Rendit të Ri Botëror, sfidës “Millosheviq”, iu përgjigj me forcën e armëve, si në rastin e Bosnjës, ashtu dhe në rastin e Kosovës. Në rrethana të një agresioni të egër dhe spastrimit etnik, SHBA si një vend që kishte marrë mbi vete rolin e përkujdesjes për paqe në Botë, nuk mund të toleronte krimet serbe. Edhe në rastin e Bosnjë-Hercegovinës dhe më pas të Kosovës, politika e jashtme amerikane, veprimi përmes të ashtuquajturve turbo-diplomatë (Holbruk, Gelbard, Hill, etj). Në përpjekjet për zgjidhje paqësore të konflikteve, SHBA shfrytëzuan instrumentet për vendosjen dhe ruajtjen e paqes, në Bosnjë sulmuan caqet ushtarake serbe, ndërsa në krizën e Kosovës sulmuan caqet ushtarake të Serbisë.

Në të vërtetë, deri në vitin 1994, politika e jashtme e SHBA-së ishte e fokusuar në embargon e armëve, duke i dhënë shans arritjes së paqes me mjete politike. Nga kjo kohë SHBA ndërmarrin iniciativën për ndërprerë procesin e ndarjes së Bonjës dhe për të përmbyllur konfliktin e armatosur. Në këtë periudhë SHBA kaluan në strategjinë “*lift and strike*”, sipas të cilës parashihej suspendimi i embargos së armëve për boshnjakët. Ndryshimi kursit të politikës së jashtme amerikane do të mundësojë sukseset ushtarake në terren kundër forcave serbe. Kursi i ri politik u jepte mundësi SHBA të marrin rolin udhëheqës në tërë procesin, si ushtarak ashtu dhe diplomatik (Touval, 1996).

Roli udhëheqës i diplomacisë amerikane për rrjedhojë pati marrëveshjen paqësore në bazën e Forcave Ajrore të SHBA-së, në Dejtton të Ohajos. Megjithatë, Marrëveshja e Dejtonit nuk i dha fund luftës në ish-Jugosllavi, sepse kishin mbetur akoma shumë çështje të tjera të pazgjidhura, për të përmbyllur “kapitullin jugosllav”.

Vlen të theksohet se, çështja e Kosovës, në kohën kur zhvilloheshin bisedimet në Dejtton, nuk ishte prioritet i politikës së jashtme amerikane. Kosova në këtë kohë mbahej nën regjim të plotë ushtarako-politor, ku keqtrajtimet e shqiptarëve etnikë ishin përditshmëri. Sipas “Human Rights Watch” në Kosovë shkeleshin të drejtat njerëzore, të shqiptarëve, duke i shtyrë shqiptarët drejt vetëmbrojtjes së armatosur.

Për shkak të përkeqësimit permanent të gjendjes, në Kosovë shfaqet lëvizja e rezistencës së armatosur kundër regjimit të Millosheviqit, e njohur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Gjatë kësaj kohe, administrata amerikane e Presidentit Bill Clinton, edhe njëherë ia rikujtoi Millosheviqit “Paralajmërimin e Krishtlindjeve” të vitit 1992. Kjo nënkuptonte se, pas Marrëveshjes së Dejtonit (1995), diplomacia amerikane e kishte fokusuar objektivin e saj për t’i dhënë fund “krizës jugosllave” dhe për të orientuar procesin drejt evropianizimit të Ballkanit. Për të arritur objektivin final, SHBA synonin demilitarizimin e Ballkanit, filluar me përmbysjen e forcës ushtarake të Serbisë, krijimin e një fryme bashkëpunimi mes vendeve të rajonit dhe së fundi integrimin e këtyre vendeve në strukturat euro-perëndimore: NATO dhe Unionin Evropian.

Në prag të Luftës së Kosovës (1999), diplomacia e SHBA, në krye të së cilës ndodhej Medlin Olbrajt, ishte e angazhuar në unifikimin e qëndrimeve të aleatëve të NATO-s. Rreth çështjeve që tashmë kishin filluar të hapen si rezultat i aktiviteteve të UÇK-së, në Kosovë (pas masakrës së Prekazit - 1998), në takimet e Grupit të Kontaktit, që mbahet në Londër, pas debateve të shumta kundërshtuese, Serbisë megjithatë i vendosen sanksionet (Albroght, 2004). Ndonëse, masat e aprovuara kundër regjimit serb, për shkak të zvarritjes së tyre, në të shumtën e rasteve nuk jepnin rezultatin e pritur për të penguar regjimin vrastar të Millosheviqit, Olbrajt, sjell konkluzion se, përshpejtimi i zgjidhjes së konfliktit duhet të drejtohet nga SHBA.

Zhvillimet në Kosovë shkonin drejt përkeqësimit të gjendjes edhe ashtu të rënduar. Përderisa zhvilloheshin përpjekjet diplomatike për gjetjen e një zgjidhje politike të krizës, më 16 janar 1999, forcat militariste serbe kryen masakrën e radhës, në Reçak, pamjet e së cilës e tronditën opinionin botëror. Pak ditë më vonë, më 29 janar 1999, në takimin e radhës së Grupit të Kontaktit, midis alternativave të mundshme vendoset të zhvillohen bisedime për paqe, të cilat u përcaktuan të mbahen në Rambuje të Francës.

Edhe përkundër përpjekjeve të jashtëzakonshme të diplomacisë ndërkombëtare, në veçanti të diplomacisë amerikane, për një marrëveshje paqësore në Kosovë, e njëjta nuk është arritur për shkak të refuzimit nga ana e serbëve.

SHBA, megjithatë provuan edhe përpjekjen e fundit për të penguar veprimet ushtarake të Millosheviqit, duke dërguar në Beograd njërin nga diplomatët më të shquar, Riçard Hollbruk. Diplomati amerikan i dorëzoi ultimatumin se, në qoftë se nuk e pranon marrëveshjen e ofruar, do të sulmohej ushtarakisht. Më 23 mars 1999, Hollbruku kthehet në Bruksel, ku i informon aleatët e NATO-s për qëndrimin negativ të Millosheviqit. Pas këtij momenti, sekretari gjeneral i NATO-s Javier Solana urdhëron gjeneralin Vesli Klark të fillojë operacionin ushtarak për të parandaluar katastrofën humanitare në Kosovë (Solana, 1999).

Gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, më 15 prill 1999, Presidenti Clinton midis tjerash, do të deklarojë: *“Ne, së bashku me 18 aleatët tanë të NATO-s, ndodhemi sot në Kosovë sepse duam ta ndalojmë masakrën dhe spastrimin etnik, sepse duam të ndërtojmë një Evropë të qëndrueshme, të bashkuar, të begatë, që të përfshijë Ballkanin dhe fqinjët e tij dhe sepse nuk duam që shekulli i XXI të mbizotërohet nga dyzimi i errët i armëve moderne me urretjen e lashtë etnike, racore dhe fetare. Ne nuk mund të rrimë e të bëjmë sehir sesi qindra-mijëra njerëz trajtohen barbarisht, vriten, përdhunohen, dëbohen me forcë nga shtëpitë e tyre, sesi u shuhen historitë e familjeve të tyre, të gjitha në emër të krenarisë e të pastërtisë etnike...!”* (Clinton, 1999).

Vlen të theksohet se, Millosheviqi, si gjithë diktatorët tjerë gjatë historisë, nuk pati kapacitet për të kuptuar se “politika” e tij e gjenocidit dhe e spastrimit etnik, për krijimin e “Serbisë së Madhe” i takonte së shkuarës historike dhe jo së ardhmes dhe se proceset qytetëruese evropiane zhvilloheshin në kahe të kundërt të mendësisë serbe.

Falë politikës së jashtme të SHBA-së, marrëdhëniet ndërkombëtare, në fillim të mijëvjeçarit të tretë do të zhvilloheshin edhe mbi parime morale, për të cilën ishin angazhuar Presidenti Uillson, Ruzvelt dhe së fundi Presidenti Bush dhe Clinton. Këto parime do të bëhen pjesë të politikave të jashtme të kombeve evropiane.

Rendi i Ri Botëror, për të cilën angazhohet politika e jashtme amerikane shkon përtej interesave egoiste të kombeve ballkanike.

PËRFUNDIM

Përderisa në shekullin XIX, Amerika konsolidohet si fuqi e madhe, në shek. XX, përpjekjet e sa do të fillojnë me propozim-idesh rreth funksionimit të marrëdhënieve ndërkombëtare (sigurimi kolektiv, vetëvendosja), duke

përfunduar me imponimin e zgjidhjeve mbi parime, të cilat shkonin përtej parimeve tradicionale të fuqive evropiane (intervenimi humanitar). Pra, parimet bazë mbi të cilat lëvizte politika e jashtme amerikane, gjatë shekullit XX, nga koha e Luftës së Parë Botërore, nisur me Presidentin Uillson, më pas Presidentin Ruzvelt dhe së fundmi Presidentët Bush dhe Klinton, e forcuan gjithnjë e më tepër SHBA-në, duke i dhënë Amerikës rolin e mbrojtësit efikas të paqes në botë. Në të vërtetë, pa SHBA-në, kombet evropiane si të veçanta, asnjëherë nuk janë dëshmuar se janë në gjendje të zgjidhin konflikte dhe as ta ruajnë paqen. Kështu ndodhi edhe gjatë kohës së luftërave në ish-Jugosllavi.

Në shekullin XX, doktrinat totalitare u diskredituan falë angazhimit të politikës së jashtme amerikane. Në periudhën vijuese, në epokën e RENDIT TË RI BOTËROR roli i SHBA-së është në vendosjen e standardeve morale në politikën e jashtme. Në këtë drejtim duhet kuptuar edhe angazhimin amerikan në vendosjen dhe funksionimin e sistemit të demokracisë parlamentare në rajonin e Ballkanit.

Gjeografia e kishte vendosur SHBA-në, në hemisferën perëndimore, ajo ishte e mbrojtur nga dy oqeanë të mëdha. Madhësia dhe rritja e madhe ekonomike në shekullin XX i mundësonte Amerikës premisa themelore për të ushtruar rolin drejtues të proceseve në marrëdhëniet globale, në fillim të mijëvjeçarit të tretë, gjithnjë duke u bazuar në vlerat e sistemit të demokracisë parlamentare, pluralizmin politik dhe ekonominë e tregut.

Pas rënies së komunizmit, SHBA është shndërruar në faktor i domosdoshëm pa të cilën pothuajse është e pamundur vendosja e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm. Si një misionare e paqes në Botë, roli i Amerikës ndoshta do ishte zbehur përballë problemeve të qytetërimit njerëzor, andaj ajo është e detyruar shpesh të shtyjë edhe aleatët perëndimorë evropianë për marrjen e vendimeve më efikase për zgjidhjen e krizave dhe vendosjen e paqes (rasti i Jugosllavisë).

Duke pasur parasysh se, demokracia parlamentare gjithnjë do të mbetet një opsion i “sulmuar” nga sisteme, apo dhe ideologji të ndryshme totalitare, si një prirje egoiste e natyrës njerëzore, Amerika, si e vetme, sigurisht se do ta kishte humbur luftën. Në misionin e saj, SHBA-së i është e nevojshme, më shumë se kurrë, një Evropë e fuqishme. Andaj, nuk është befasi përpjekja amerikane për të vendosur paqen dhe stabilitetin në tokën e origjinës së vlerave demokratike. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe përpjekja e diplomacisë amerikane, për bashkëpunimin rajonal (vendet e Ballkanit Perëndimor), duke përgatitur shtegun, për të gjitha vendet e rajonit, drejt integritetit në NATO dhe Unionin Evropian.

Mirëpo, përpara ballkanasve, në veçanti për ne shqiptarët, shtrohet dilema, e cila kërkon përgjigje të shpejtë, në radhë të parë nga klasa akademike: Në ç’kahe lëvizin proceset shoqërore në rajon dhe në veçanti në hapësirën shqiptare, dhe në qoftë se këto procese lëvizin në kahe të drejtë, atëherë në çfarë stadi jemi ne shqiptarët dhe të tjerët?

Me këtë rast, dëshiroj të theksoj se, në kohën e sotme, *revolucionarizimi i ideve progresive*, siç janë idetë *euro-perëndimore*, pra *pro Rendit të Ri Botëror*, të cilat mund të jenë vetëm produkt i klasës së mirëfilltë akademike, është i pashmangshëm. Kjo do ta ndërrojë klasën politike të kohës për t’i përkapë proceset bashkëkohore. Në qoftë se kjo nuk mund të ndodhë për shkak të “shterpësisë” së politikanëve, atëherë klasa akademike duhet të imponohet si faktor në jetën shoqërore-politike me qëllim të marrjes së përgjegjësisë që i takon përballë zhvillimeve shoqërore bashkëkohore.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- [1] Ahrens, Geert Hinrih, (2010), *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Tiranë.
- [2] Albright, Madeleine, (2004), *Zonja Sekretare* (autobiografi), Tiranë.
- [3] Banac, Ivo, (2001), *Raspad Jugosllavije*, Zagreb.
- [4] Buxhovi, Jusuf, (2009), *Kthesa historike 1*, Prishtinë.
- [5] Human Rights Watch, (1996) *Raporti Botëror*.
- [6] Joviç, Borisav, (1995), *Poslednji dani SFRJ*, Beograd.
- [7] Kadujeviç, Veljko, (1993), *Moje vidjenje raspada*, Beograd, 1993.
- [8] Kovaçević, Zhivorad, (2007), *Amerika i raspad Jugosllavije*, Beograd.
- [9] Klinton, Bill, (1999), *Ne luftën, ju paqen. Fragment nga komentet e Presidentit Bill Klinton drejtuar Shoqërisë Amerikane të Reporterëve të Gazetave lidhur me situatën në Kosovë. Hoteli Fairmont, San Francisko, Kaliforni, ora 3:06, e enjte, 15 prill 1999*; Tiranë.
- [10] Nathanaili, Petrit, (2009), *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga origjina e deri më sot*, Tiranë.
- [11] Silajxhiq, Haris, (1999), *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*, Tiranë.
- [12] Touval, Saadia, (1996), *Coercive Mediation on the Road to Dayton*, International Negotiation I, Kluwer Law International, Holandë.
- [13] Press Statement by Javier Solana, 23 March 1999.
- [14] Wesley, Clarck, (2001), *Waging Modern War*, New York.
- [15] Zenelaj, Egerem, (2013), *Historia e diplomacisë*, Prishtinë.

